



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilaški Savet Kosova/ Kosovo Prosecutorial**  
**Council**

Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të nenit 4 paragrafi 1.27 dhe nenit 11 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës Nr. 03/L-224 dhe nenit 15 të Rregullores Nr. 10/2015 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur më datë 29 korrik 2016, miratoi këtë:

**R R E G U L L O R E NR.07/2016**  
**PËR PROCEDURËN DISIPLINORE PËR ANËTARËT E KËSHILLIT**  
**PROKURORIAL TË KOSOVËS**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Kjo Rregullore përcakton procedurën për hetimin e sjelljes së pahijshme të anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe zhvillimin e procedurës disiplinore ndaj tyre.

**Neni 2**  
**Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

<b>Këshilli</b> .....	Këshilli Prokurorial i Kosovës;
<b>Kryesuesi</b> .....	Kryesuesi i Këshillit Prokurorial
<b>Komisioni Disiplinor <i>ad hoc</i></b>	Komisioni Disiplinor i themeluar nga Kryesuesi në pajtim me nenin 11.2 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe sipas dispozitave të përcaktuara me këtë Rregullore.
<b>Sekretariati i Këshillit</b> .....	Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës

### **Neni 3**

#### **Sjellja e pahijshme**

Sjellje e pahijshme nënkupton çdo veprim në kundërshtim me Kushtetutën, Ligjin dhe rregulloret e Këshillit, si dhe çdo shkelje e paraparë me Kodin e Etikës dhe sjelljes profesionale për anëtarët e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

### **Neni 4**

#### **Bazat për fillimin e procedurës disiplinore**

1. Anëtarët e Këshillit i nënshtrohen procedurës disiplinore në rastet kur:
  - 1.1 Ka kryer shkelje të Kodit të Etikës dhe sjelljes profesionale për anëtarët e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
  - 1.2 Nuk e ka ushtruar funksionin e anëtarit të Këshillit në pajtim me Kushtetutën, Ligjin dhe rregulloret e Këshillit.

### **Neni 5**

#### **Inicimi i hetimit disiplinor**

1. Këshilli inicion hetim disiplinor ndaj një anëtari në rastet si në vijim:
  - 1.1 kur parashtrohet ndonjë ankesë, dhe
  - 1.2 sipas detyrës zyrtare.

### **Neni 6**

#### **Themelimi i Komisionit Disiplinor *Ad hoc***

1. Kryesuesi i Këshillit në pajtim me nenin 11 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, brenda 15 ditësh nga data e pranimin të parashtrësës së palës apo indikacionit për kryerjen e sjelljes së pahijshme, e themelon Komisionin Disiplinor *ad hoc* për të hetuar sjelljen e supozuar të pahijshme të anëtarit të Këshillit.
2. Nëse subjekt i procedurës është Kryesuesi i Këshillit, Komisionin Disiplinor *ad hoc* e themelon Zëvendës kryesuesi i Këshillit.
3. Anëtari i Këshillit i cili është subjekt i procedurës disiplinore nuk merr pjesë në diskutimet apo votimet në çështjet e tij.

**Neni 7**  
**Përbërja e Komisionit Disiplinor *ad hoc***

1. Komisioni Disiplinor *ad hoc* përbëhet si ne vijim:
  - 1.1 dy anëtarë nga Këshilli dhe
  - 1.2 një prokuror nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.
2. Me rastin e themelimit të Komisionit, Kryesuesi ka parasysh përbërjen e Komisionit varësisht nga anëtari i Këshillit i cili është subjekt i procedurës.

**Neni 8**  
**Procedura disiplinore**

1. Me fillimin e hetimit, Komisioni Disiplinor *ad hoc* njofton anëtarin e Këshillit ndaj të cilit zhvillohet procedura hetimore.
2. Procedura disiplinore kryhet jo më vonë se një muaj nga dita e themelimit të Komisionit Disiplinor *ad hoc*, përveç ne rastet te caktuara kur Kryesuesi mund te vazhdoj edhe një afat shtese prej 15 ditësh.
3. Sekretariati i Këshilli i dërgon materialet me shkrim dhe dokumentet tjera të nevojshme anëtarëve të Komisionit për shqyrtim së paku shtatë (7) ditë pas marrjes së vendimit për themelimin e Komisioni Disiplinor *ad hoc*.
4. Anëtarët e Komisionit Disiplinor *ad hoc* janë të obliguar ta nënshkruajnë konfirmimin për pranimin e njoftimit për seancë dëgjimore dhe pranimin e shkresave të lëndës.

**Neni 9**  
**Shqyrtimi**

1. Komisioni Disiplinor *ad hoc* mban seancë të mbyllur për shqyrtim të çështjes disiplinore.
2. Komisioni Disiplinor *ad hoc* ka të drejtë të kërkojë informacione nga anëtari i Këshillit ndaj të cilit është duke u zbatuar procedura disiplinore me qëllim të qartësimit të ndonjë fakti.
3. Komisioni disiplinor *ad hoc* mund ta ftojë anëtarin e Këshillit ndaj të cilit është duke u zhvilluar procedura disiplinore që të deklarohet lidhur me çështjen, qoftë verbalisht apo me shkrim.

**Neni 10**  
**Votimi i Komisionit disiplinor *ad hoc***

1. Komisioni Disiplinor *ad hoc* voton lidhur me përgjegjësinë e anëtarit të Këshillit.
2. Komisioni Disiplinor *ad hoc* voton në ditën e mbajtjes të seancës së fundit.
3. Komisioni Disiplinor *ad hoc* vendos me shumicë votash.
4. Procesverbali për shqyrtim dhe votim përpilohet nga Sekretari i Komisionit Disiplinor *ad hoc*. Procesverbali nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit dhe vendoset në një kuvertë të vulosur. Ky dokument i cili është konfidencial i bashkëngjitet dosjes.

**Neni 11**  
**Vendimet e Komisionit Disiplinor *ad hoc***

1. Pas përfundimit të hetimit, nëse Komisioni Disiplinor *ad hoc* gjenë se anëtari i Këshillit ka bërë shkelje Komisioni Disiplinor *ad hoc* vendos për:
  - 1.1 Qortimin, dhe
  - 1.2 Pezullimin nga detyra e anëtarit të Këshillit, deri në marrjen e vendimit përfundimtar.
  - 1.3 Komisioni Disiplinor *ad hoc* pezullon anëtarin e Këshillit çdo here nëse anëtari i Këshillit është nën arrest ose i paraburgosur dhe kur suspendohet nga funksioni i cili i ka dhënë bazën për emërim në Këshill.
2. Komisioni Disiplinor *ad hoc* i propozon Këshillit shkarkimin anëtarit nëse gjenë se anëtari i Këshillit nuk e ka ushtruar funksionin e anëtarit të Këshillit në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin, ka ushtruar funksionin në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e tij apo është dënuar për vepër penale.
3. Vendimi në formë të shkruar i Komisionit Disiplinor *ad hoc* përgatitet brenda tridhjetë (30) ditë pune duke filluar nga data e seancës përfundimtare. Vendimi i shkruar nënshkruhet dhe përmban arsyet mbi vendimin lidhur me shkeljen e bërë dhe sanksionin, nëse kjo është vërtetuar.

4. Nga një kopje e vendimit u dërgohet palëve pa vonesë. Konfirmimin mbi pranimin e vendimit e siguron Sekretari, me të cilin dëshmohet se palët e kanë pranuar vendimin e Komisionit dhe i njëjti i bashkëngjitet dosjes.
5. Në rast se Komisioni Disiplinor *ad hoc* nuk gjen shkelje i raporton Kryesuesit respektivisht zëvendës kryesuesit i cili njofton Këshillin për të gjeturat e Komisionit Disiplinor *ad hoc*.

#### **Neni 12**

##### **Procedura e Ankimit ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor *ad hoc***

1. Anëtari i Këshillit i cili pezullohet apo i shqiptohet masa e qortimit nga Komisioni Disiplinor *ad hoc* ka të drejtë ankese para Këshillit në afat prej 15 ditëve nga pranimi i vendimit.
2. Ankesa përmban të dhënat, si në vijim:
  - 2.1 Emrin dhe mbiemrin e ankuesit;
  - 2.2 Datën e vendimit, kundër të cilit paraqitet ankesa;
  - 2.3 Pjesa e kontestuar;
  - 2.4 Bazat dhe arsyet për ankesë;
  - 2.5 Propozimin për vendim -marrje, dhe
  - 2.6 Nënshkrimin e ankuesit.
3. Ankesa parashtrohet në Zyrën e Kryesuesit të Këshillit, e cila e procedon për shqyrtim në Këshill.

#### **Neni 13**

##### **Vendimet e Këshillit Prokurorial të Kosovës**

1. Këshilli nxjerr vendim mbi ankesën brenda 30 ditësh nga pranimi i ankesës.
2. Këshilli e hedh poshtë ankesën, nëse konstaton se ankesa është e palejuar ose e pas afatit.
3. Këshilli pas konstatimit se ankesa është e lejuar dhe e afatshme, mund ta refuzojë, aprovojë ose ta ndryshojë vendimin e Komisionit Disiplinor *ad hoc*.
4. Vendimi i Këshillit është me shkrim dhe përmban arsyetimin e vendimit.
5. Këshilli e shkarkon nga funksioni anëtarin prokuror me dy të tretat e votave.

6. Për anëtarët jo-prokurorë të Këshillit kur Komisioni Disiplinor *ad hoc* gjenë se anëtari ka bërë shkelje nga neni 11 paragrafi 2, Këshilli i propozon Kuvendit të Kosovës shkarkimin e anëtarit jo-prokuror.
7. Anëtarët e Komisionit Disiplinor *ad hoc* që janë anëtar të Këshillit, përjashtohen nga diskutimi dhe vendimmarrja në Këshill, për çështjen për të cilën kanë vendosur masa ose kanë rekomanduar shkarkimin.
8. Ndaj vendimit të Këshillit për shkarkim, anëtari i Këshillit ka të drejtë në ankesë në Gjykatën Supreme brenda 15 ditëve nga pranimi i vendimit.

#### **Neni 14** **Publikimi i Vendimeve**

1. Këshilli e mban regjistrin publik, në të cilin publikohen vendimet e Komisionit Disiplinor *ad hoc* dhe të Këshillit. Procedurat e Këshillit janë jo-publike derisa të merret vendimi përfundimtar.
2. Këshilli e mban regjistrin për të gjitha rastet dhe i njëjti përmban:
  - 1.1 Numrin e lëndës;
  - 1.2 Llojin dhe natyrën e shkeljes;
  - 1.3 Datën kur është parashtruar lënda;
  - 1.4 Vendimin dhe masën disiplinore;
  - 1.5 Ankesën e palës dhe kohën e ankesës, dhe
  - 1.6 Vendimin përfundimtar.
2. Regjistri publik publikohet në faqen zyrtare të Këshillit dhe përditësohet periodikisht.

#### **Neni 15** **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli.

Prishtinë, më 29 korrik 2016

Blerim Isufaj  
Kryesues  
Këshilli Prokurorial i Kosovës

